

Efiçienca e buxhetit të Bashkisë Skrapar (Viti 2019)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2019

Studimi ka për qëllim të analizojë efiçencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2019, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	119,903	1,164,107	36%
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	6,635	64,417	2%
Transferta specifike	100,343	974,204	30%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	43,073	418,184	13%
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	64,504	626,252	19%
TOTALI	334,458	3,247,165	100%

Burimi: Bashkia Skrapar (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Skrapar 2019



Burimi: Bashkia Skrapar (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Skrapar për vitin fiskal 2019

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2019. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale 2019

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	225,403	2,188,379	67.4
Shpenzime operative	63,643	617,893	19.0
Shpenzime Kapitale	56,310	546,699	16.8
TOTALI	345,356	3,352,971	103.3


Burimi: Bashkia Skrapar (llogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Skrapar (llogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Skrapar (llogaritje EIC)